

V E N D I M
Nr. 632, datë 21.11.2001

PËR MËNYRËN E PAGESËS SË BANESËS QË TË VERBRIT E GRUPIT TË PARË
PËRFITOJNË NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7 dhe 17 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave për trajtimin me përparësi nga shteti, të planifikojë fonde për strehimin e të verbërve të grupit të parë, në bazë të kërkesës së Shoqatës të së Verbërve të Shqipërisë.

2. Çdo i verbër i grupit të parë përfiton falas një dhomë me sipërfaqe 12.5 -14 m2 mbi sipërfaqen normative dhe përshtatjen e banesës sipas kushteve fizike. Për banesat që do t'u jepen qytetarëve me statusin e të verbrit të përdoren normat ekzistuese të projektimit deri në nxjerrjen e normave të projektimit për të verbrit. Shpenzimet për përshtatjen e banesës të mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

3. Shpenzimet operationale, që do të kryhen nga Enti Kombëtar i Banesave për banesat e ndërtuara apo të blera në tregun e lirë, të përballohen nga fondet e dhëna për strehim ose t'i njihen kësaj të fundit si shlyerje detyrimi ndaj Buxhetit të Shtetit.

4. Të verbrit e pastrehë të grupit të parë të shlyejnë diferencën ndërmjet vlerës së banesës, me përfitimet nga statusi i të pastrehut dhe nga ky vendim.

5. Kur të verbrit e grupit të parë nuk pranojnë të marrin dhomë tepër, vlera e kësaj dhome zbritet nga vlera e banesës që do të përfitojnë.

6. Kur të verbrit e pastrehë të grupit të parë, që kanë përfutur banesë nga Enti Kombëtar i Banesave, u bëhet zbritja e vlerës së përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi, Enti Kombëtar i banesave nuk u detyrohet qytetarëve nëse përfitimi falas rezulton më i lartë se masa e kredisë, që ata duhet të shlyejnë.

7. Kërkesat për strehim administrohen nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, e cila përcakton radhën dhe përparësitë e trajtimit, strukturat që i takojnë çdo familjeje, duke specifikuar edhe dhomën shtesë, dhe i dërgon këto dokumente, brenda datës 1 gusht të çdo viti, pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Turizmit. Dokumentacioni i plotë i dërgohet Entit Kombëtar të Banesave. Ky dokumentacion përmban edhe dokumentin zyrtar të librezës së verbërisë, sipas modelit të përcaktuar nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë, si dhe vërtetimin nga bashkia, për statusin e të pastrehut.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, organet e qeverisjes vendore dhe Enti Kombëtar i Banesave, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta